



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-1126-22437
Datë 15.11.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me datë 15.11.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Pranimit (*Përzgjedhjes*) për Shërbimin Publik në Komunën e Gjakovës për zhvillimin e procedurave të vlerësimit për grupin *Sekretar të Shkollave*.
2. Komisionin e Pranimit (*Përzgjedhjes*) nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Bajram Salihi – Kryesues (*Drejtor i SHFMU “Ali Hasi”*)
 - 2.2. Jeta Haraçia – Anëtare (*Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*)
 - 2.3. Zymber Berisha – Anëtarë (*Udhëheqës i Sektorit për Arsim*)
 - 2.4. Dervish Tahiri – Anëtarë (*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*)
 - 2.5. Mergim Delija – Anëtarë (*Drejtor i SHFMU “Dëshmorët e Dushkajës”*)
3. Komisioni i Pranimit (*Përzgjedhjes*) ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin profesional të kandidatëve që përfshin testimin me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i kandidatëve apo teknikë tjetër ekuivalente dhe të përshtatshme për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale, si dhe intervistën me gojë në përputhje me dispozitat e Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik.
4. Komisioni i Pranimit (*Përzgjedhjes*) nga pika 1 e këtij vendimi, është me mandat dy (2) vjeçar nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit të Pranimit (*Përzgjedhjes*)
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

